

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERSONALITET JURIDIK
TE KUFIZUAR " AVDOLLI " Sh.p.k.**

Sot, me daten 09.11.2001 , me çilesine e ortakut te vetem themelues , une Florant AVDOLLI , i biri i Qamilit , i datlindjes/25.05.1967 , me shtetesi dhe kombesi shqiptare me banim ne Veshtemisht Korce , kam vodosur themelimin e shoqerise tregtare " AVDOLLI "

Me nenshkrimin e ketij akti themelimi te nje shoqerie tregtare, nenshkruesi dhe themeluesi i saj merr persiper te realizoje e te respektoje te drejtat dhe detyrimet me precizimet e me poshtme :

NENI 1

Ne perputhje me kerkesat e ligjit shqiptar Nr.7638 date 19.11.1992 eshte formuar shoqeria tregtare " AVDOLLI " shpk .

NENI 2

Shoqeria e ka seline e saje ne Korce ne zonen "Industriale" Veshtemi.
Kohezgjatja e shoqerise parashikohet te jete 10 vjet , por ky afat mund te nderpritet apo te zgjatet me tej , gjithmone ne funksion te kompetencave te ortakut te vetem themelues .

NENI 3

Si rregull aktiviteti i shoqerise mund te zhvillohet ne te gjithe territorin e R.Shqiperise, me hapjen e filialeve apo nepermjet veprimtarive te tjera te karakterit tregtar , ne perputhje me legjislacionin perkates .

NENI 4

Kapitali themeltar i Shoqerise " AVDOLLI " Shpk ne momentin fillestar te krijimit eshte 100 000 (qind mijë) leke i cili regjistrohet ne llogarine e shoqerise prane Bankes Shqiptare.

NENI 5

- Objekti i veprimtarise se Shoqerise " AVDOLLI " Shpk do te jete :
1. Prodhimi dhe tregetimi me shumice e pakice i materialeve te ndryshme te ndertimit.
 2. Perpunim i materialeve drusore per ndertim dhe tregtimi i tyre.
 3. Import dhe eksport per mallra industriale dhe ushqimore.
 4. Servis per makineri .

NENI 6

Ortaku i veteini Themelues Florant AVDOLLI , ka vodosur qe dhe si administrator i Shoqerise " AVDOLLI " Shpk te jete po vete ai .

Ai per gjigjet mbi bazen e kompetencave te tija te percaktuara ne aktet e themelimit te shoqerise. Gjithashtu konfirmon emrat e ortakeve qe mund te shtohen , pjeset e kapitalit themeltar si dhe shumen e derdhur nga secili prej tyre .

Gjithashtu ai per gjigjet per administrimin e vlerave pasurore te Shoqerise, te cdo natyre qofshin, te shlyeje detyrimet qe ka shoqeria me te tretet, te beje mbi bazen e kontributive te dhena prej ortakeve shperndarjen e fitimit .

Si organ ekzekutiv i Shoqerise " AVDOLLI " Shpk eshte asambleja e ortakeve. Te drejtat dhe detyrat e administratorit , tregullohen me Aktet Themeluese te Shoqerise , me aktet e tiera normative te nxierra noa asambleja e Ortakeve apo dhe me marreveshje te tiera te

te Shoqerise "AVDOLLI" Shpk sikurse parashikohet ne legjislacionin e Shtetit Shqiptar dhe ne menyre te vecante ne "Kodin e Shoqerive Tregtare".

NENI 10

Kjo Kontrate Themelimi hartohet ne Tirane ne 5 ekzemplare originale , duke patur secila nga kopjet vlore te barabarte ligjore e kuptimore .

NENI 11

Ortaku i vetem pasi u njoh dhe kuptoi drejt te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga ky Akt-Themelues i Shoqerise "AVDOLLI" Shpk e gjeti me vend dhe e firmosi ate .

Ortaku i vetem
Florant AVDOLLI

Florant Avdelli
Flevo

DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 2370 Rep.
Nr. 159 Kol

VERTE TIM

Ne qytetin e Tiranes, sot me daten 12.11.2001 (dymije e nje), ne zyren e noterise, para meje noteres Violeta ISARAJ, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me adresen: Rr.Kavajes, Pll.3, u paraqit personalisht: Z.Florant AVDOLLI, i biri i Qamiles dhe i Skenderies, lindur me 25.05.1967, dhe banues ne Vashtemi Korce, me nr. pasaporte , i cili pranon se ka perpiluar aktin e themelimit te Shoqerise "AVDOLLI" Shpk jashte kesaj zyre, dhe meqense e gjen ne perputhje te plete me vullnetin e tije te lire e nenshkuaran rregullisht perpara meje .

Une noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE
Violeta Isaraj

Isaraj

Violeta

[Signature]





**STATUTI
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"AVDOLLI" SH.P.K.**

Personat që nënshkruajne këtë Statut janë :

FLORANT AVDOLLI, i biri Qamilit e Skenderies, lindur me 25.05.1967 dhe banues ne Vashtemi Korce, banesa nr.15, madhor me zotesi plete juridike per te vepruar, me Nr.Pas. 1522449.

KREU I

FORMA, EMERTIMI I SHOQERISE, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1

Forma

Shoqeria "AVDOLLI" Sh.p.k eshte nje person juridik shqiptar dhe aktivitetin e saj e ushtron ne perputhje me legjislacionin shqiptar tregetar e civil në fuqi dhe me dispozitat e ketij statuti.

Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emërtimi i shoqërisë është Shoqëria Tregetare "AVDOLLI" sh.p.k.

Për efekt të këtij statuti Shoqëria "AVDOLLI" sh.p.k. më poshtë do të quhet *Shoqeria*.

Neni 3

OBJEKTI

1. Prodhimi dhe tregerim me shumice e pakic i materialeve te ndryshme te ndertimit.
2. Perpunim i materialeve drusore per ndertim dhe tregtimi i tyre.
3. Import dhe eksport per mallra industriale dhe ushqimore.



**Neni 4
Personaliteti juridik**

Shoqeria do te filloje veprimtarine si e tille pas depozitimit te akteve ne Zyren e Regjistri



**Neni 5
Selia e Shoqeris**

Selia e Shoqeriat është në Zona industriale Vashtemi Korce. Transferimi i selisë së shoqërisë në një adresë tjeter bëhet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**Neni 6
Çelja e filialeve, degeve dhe perfaqesive**

Shoqeria mund të çele filiale, degë dhe zyra perfaqësimi në qytete të tjera të Shqipërisë, sipas legjisacionit shqiptar ne fuqi.

**Neni 7
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqeriat është përcaktuar deri në 12 Nentor 2011. Kjo periudhe mund te zgjatet tej afatit te mesiperm apo te zvogelohet me miratimin e Asamblesë së Ortakëve.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

**Neni 8
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i Shoqerise është 100.000 lekë. dhe plotësisht i shlyer.

**Neni 9
Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit**

Ortakët nuk kufizohen ne rritjen e kapitalit themeltar. Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrim proporcionalisht me shumën e pjesëve të tyre. Shoqeria mund të zvogëlojë kapitalin e tij. Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Ortakëve. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë, pra në mënyrë proporcionale me kapitalin që ato kanë. Ortakët i marrin vendimet në mbledhjen e Asamblese me shumice te cilesuar te votave.

Ortakët i marrin vendimet në mbledhjen e Asamblese me shumice te cilesuar te votave.

Neni 10

Pjeset e Kapitalit Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqeriat eshte ai i cituar ne nenin 8 te ketij Statuti i cili zotrohet 100%nga ortaku themelues Florian Avdolli.

Neni 11

Afatet e vendosjes dhe pjesët e kapitalit themeltar.

Kapitali në para është paguar tashmë nga admisnitratori dhe është depozituar ne Banken e Kursimeve Tirane ne një llogari te hapur ne emer te Shoqerise.

Neni 12

Lënia dhe transferimi i pjesëve të kapitalit.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nga administratori.

**KREU III
TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKAVE**

Neni 13

Te drejtat

Ortaku gjzonë këto të drejta kryesore:

Drejtimin e veprimtarise se Shoqerise ne perputhje me kete Statut dhe nëpërmjet pjesmarrjes së tyre në Asamblenë e Ortakëve.

Pjesemarrjen ne rezultatet e çdo forme e sasie te veprimtarise se Shoqerise.

Emerimin e Administratorit.

Marrjen e te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomiko-tregtare dhe me llogarite ekonomike si dhe me veprimtarinë e Shoqerise.



Paraqitjen e keresave, verejtjeve e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Asambleja e Ortakëve, sipas ketij Statuti.
Transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar ndërmjet tyre ose personave te tretë.



Neni 14

Detyrat e ortakëve.

Ortaku ka keto detyra kryesore:
Te marre pjese ne drejtimin e Shoqerise si dhe ne administrimin e saj, sipas e në bazë të rregullave të vendosura në këtë Statut.

T'i jap

Shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e çdo objektivi lidhur me veprimatrine e saj.

Te kryejne detyrat per realizimin e objektit dhe te funksioneve te Shoqerise.

Te derdhin kontributet e tyre për formimin e kapitalit themeltar sipas pjesëve takuese.

KREU IV MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

Neni 15

Ortakët dhe Asambleja e Ortakëve.

Organi më i lartë vendimor i Shoqeriat është Asamblea e Ortakëve.

Vendimet e marra nga Asambleja, ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe kete Statut, janë te detyrueshme per gjithe ortaket.

Çdo ortak merr pjesë në vendimet e Asamblesë dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Me ushtrimin e të drejtës për të marrë pjesë në vendimet e Asamblesë çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër i zgjedhur dhe i autorizuar me shkrim prej tij.



Neni 16
Mbledhja e Asamblesë

Mbledhja e Asamblesë mund të thirret nga njëri prej ortakëve, nga Administratori, nga ekspertët kontabël të autorizuar ose nga likuidatori.

Mbledhjet e Asamblese jane te zakoneshme dhe te jashtezakoneshme.

Mbledhja e zakoneshme e Asamblese se Ortakeve thirret cdo vit brenda kater muajve te fundit te viti financiar.

Mbledhja e zakoneshme e Asamblese se Ortakeve thirret që bëre me shkrim nga personat që plotësojnë kushtet e

Ajo mund te thirret gjithashtu sa here qe Administratori e cmon te arsyeshme.
Asamblea e Ortakëve mblidhet pas 15 ditëve të njoftimit të bërë me shkrim nga personat që plotësojnë kushtet e përmëndura në paragrin e pare nëpërmjet letër rekomandesë ose njoftimit me shkrim të bërë nga Drejtori Administrativ.

Mbledhja e zakoneshme e Asamblese se Ortakeve vendos për çështje të tilla si : emërimin ose shkarkimin e Keshillit Administrativ, likuidatorit, miratimin e raporteve të administrimit dhe kontrollit, etj.

Mbledhja e jashtezakoneshme e Asamblese se Ortakeve vendos për çështje të tilla si : ndryshimet e statutit, zvogëlimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretë, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndrrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, etj.

Mbledhja e zakoneshme e Asamblese se Ortakeve ne thirrjen e pare mund të marrë vendime të vlefshme në qoftë se janë të pranishëm një numër ortakësh që zotërojnë mbi 1/2 e pjesëve të kapitalit themeltar dhe vendimet merren me shumicë votash (50%+1).

Në qoftë se mbledhja e parë e Asamblesë së zakonshme nuk realizon këtë shumicë, thirret mbledhja e dytë e cila mund të marrë vendime të vlefshme me shumicë (50%+1) votash pavarësisht se sa pjesë të kapitalit themeltar zotërojnë ortakët e pranishëm.

Mbledhja e jashtezakoneshme e Asamblese se Ortakeve kërkon kushte prezence të njëjtë me ato të Mbledhjes se zakoneshme te Asamblese se Ortakeve, por ajo merr vendime me shumice te cilesuar votash (2/3 +1).

Vendimet e Asamblesë firmosen nga gjithe ortaket.

Neni 17
Administrimi



Shoqëria administrohet nga Administrator i cili eshte Florant AVDOLLI.

Ai kryen te gjitha veprimet juridike me të tretët në emër të Shoqeriase dhe realizon drejtimin e veprimitarise se përditeshme te shoqerise.

Neni 18
Ekspertri kontabël i autorizuar

Kontrolli i Shoqerise kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite financiare me të drejtë se rizgjedhjeje. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ne rast se kryhen shkelje, verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

KREU V
VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE, REZERVA E DOMOSDOSHME

Neni 19
Viti finanziar, llogarite vjetore

Çdo vit finanziar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vittit finanziar dhe raportet e veçanta te hartuara nga Administratori dhe nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Asambleja e Ortakeve

Neni 20
Rezervat e domosdoshme dhe ndarja e fitimit

Shoqeria, nga fitimi i realizuar gjate vittit finanziar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjet e vittit te meparshem, rezervon një shume me vlerë te pakten 1/10- ten e tij, e cila destinohet per formimin e fondit rezerve te domosdoshem.

KREU VI
ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI



Neni 21

Zgjatja e afatit

Me perfundimin e afatit te percaktuar ne nenin 7 te ketij statuti, zgjatja e tij mund te vendoset nga Asamblea Ortakëve.

Neni 22

Likuidimi


Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së tij. Për kryerjen e këtij procesi Asamblea Ortakëve emëron një ose disa likuidues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjëndjen e aktivit dhe pasivit të Shoqerit, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Në fund të këtij procesi, Asamblea e Ortakëve vendllos për bilancin financier përfundimtar, për aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit e për heqjen e mandatit të tij likuidues si dhe për mbylljen e procesit të likuidimit.

Neni 23

Çështjet që nuk trajtohen në këtë Statut rregullohen sipas legjisacionit përkatës shqiptar.

Neni 24

Ky statut është hartuar në Tiranë, në 4 ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe, duke patur te gjitha tekstet të njëjtën fuqi ligjore.



ADMINISTRATORI

FLORIANT AVDOLLI
Florant Avdolli'